

Prishtinë 27/06/2006
Kodi i ZRRE-së: D_11_2006

Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Mandatin ligjor sipas Neneve 45 deri 48 të Ligjit nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
2. Marrëveshjen midis Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) dhe Operatorit të Pavarur të Transmetimit dhe Tregut (ITSMO-OPSTT) – “Marrëveshja në lidhje me marrëdhënien e përkohshme komerciale dhe operacionale midis KEK KA dhe KOSTT KA mbi transferimin e përgjegjësisë për vënien në aktivitet dhe mirëmbajtjen e Rrjetit të Transmetimit tek KA KOSTT– më datë 22 qershor 2006”, tani e tutje duke iu referuar si “Marrëveshja”.
3. Protokollin e Mbledhjes midis ZRRE-së, OPSTT, KEK-ut, më datë 17 maj 2006.
4. Aplikacionet e rishqyrtuara që ka paraqitur KEK-u në ZRRE më 22 qershor 2006 dhe OPSTT –ja më 23 qershor 2006.

Ka vendosur të aprovojë aplikacionin për Tarifën e Përkohshme të OPSTT (TPO) dhe mbi çështje specifike që kanë të bëjnë me:

- a) Lidhjen midis normave të pagesave të Opeksit nga KEK-u në OPSTT
- b) Ndarjen e mekanizmit të kompensimit Ndër-OST (CBT-TNK) i cili mund të merret për periudhën korrik 2004 - korrik 2006.

Kapitulli 1: Bazat Ligjore

1. ZRRE-ja ka vendosur mbi Tarifën e Përkohshme të OPSTT-së (TPO), bazuar në mandatin ligjor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) në lidhje me Rregullimin e Çmimit siç është përmendur në Nenet 45 deri 48 të Ligjit Nr. 2004 / 9 mbi Rregullatorin e Energjisë.
2. Si pjesë e ndarjes së Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) dhe Operatorit të Pavarur të Transmetimit dhe Tregut (ITSMO-OPSTT), dy palët kanë rënë dakord të krijojnë një TPO për të administruar pagesat e KEK-ut ndaj OPSTT-së prej datës së ndarjes më 1 korrik 2006, deri në fund të vitit aktual financiar, më 31 dhjetor 2006 “Marrëveshja”.
3. OPT-ja ka qenë e negociuar drejtpërdrejtë midis KEK-ut dhe OPSTT-së. Sidoqoftë, të dyja palët kanë kërkuar gjithashtu që ZRRE-ja të lehtësojë këto negociime dhe, të japë vendimin e vet për OPT-në përfundimtare të negociuar, duke u bazuar në detyrat dhe autoritetin e vet ligjor në lidhje me tarifën e rregulluar. Palët kanë kërkuar gjithashtu që ZRRE-ja të nxjerrë një vendim i cili do të detyrojë të dyja palët nëse ato nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje të përbashkët në suazë të OPT-së,.

- 4 Për të shmangur dyshimin OPT-ja nuk është aplikim për tarifë dhe OPT-ja përfundimtare e aprovuar nuk përfaqëson një 'tarifë të rregulluar' të aprovuar nga ZRRE-ja. ZRRE-ja ka kufizuar shqyrtimin dhe vendimin e vet vetëm në ato fusha ku dy palët nuk janë në gjendje të arrijnë në një marrëveshje të përbashkët.
- 5 Veçmas, ZRRE-ja është duke kryer një shqyrtim të plotë të ndërmarrjeve të energjisë elektrike, pas së cilit, ndërmarrjet do të priten të paraqesin për shqyrtim dhe aprovim të ZRRE-së tarifat e rregulluara që kanë propozuar. Pritet që tarifat e reja të rregulluara të hyjnë në fuqi prej 1 janarit 2007. duhet të theksohet se ZRRE-ja nuk ka shqyrtuar ose aprovuar kostot operacionale dhe shpenzimet kapitale që përfshihen në OPT dhe se tarifat e rregulluara do të përcaktohen duke u bazuar në një shqyrtim të veçantë të të ardhurave vjetore të lejuara, pa ndërhyrje në kostot që përfshihen në OPT.
6. Bazuar në propozimin e rishikuar të OPT-së që është dorëzuar nga KEK-u në ZRRE më 22 qershor 2006 adhe më 23 qershor 2006 nga OPSTT-ja, si dhe bazuar në protokollin e mbledhjes së mbajtur më 17 maj 2006 midis KEK dhe OPSTT-së dhe mbështetur nga ZRRE-ja, kjo e fundit ka kuptuar se duhen adresuar dy çështje:
 - Lidhjen midis normave të pagesave të Opeksit nga KEK-u në OPSTT
 - Ndarjen e mekanizmit të kompensimit Ndër-OST (CBT-TNK) i cili mund të merret për periudhën korrik 2004 - korrik 2006

Kapitulli 2: Lidhja midis normave të pagesave të Opeksit nga KEK-u në OPSTT

Edhe pse KEK-u dhe OPSTT-ja kanë përmendur propozimet e tyre që janë përkatësisht €1.52m dhe €1.7m, në mbledhjen e 17 majit 2006 midis dy palëve është rënë dakord që OPSTT-ja do të ketë një buxhet minimal prej €1.61m për gjysmën e dytë të vitit 2006 në marrëveshje me lidhjen e përmendur më poshtë e që bazohet në stimulim me normën e mbledhjes (inkasimit) së KEK-ut.

Bazuar në buxhetin që i është caktuar OPSTT-së prej €3.57m për vitin 2006 dhe në përmbushjen e normës së inkasimit nga KEK-u prej €92m në vitin 2006 (duhet konsideruar si synim 100%), ZRRE-ja vendos që buxheti i realizuar për OPSTT-në do të lidhet direkt me përqindjen e normës së inkasimit nga KEK-u. Nëse përmbushja e inkasimit është më e lartë /ulët se 100%, atëherë OPSTT-ja do të marrë një buxhet më të lartë/ulët në raport të njëjtë me buxhetin e caktuar ndaj përqindjes mbi/poshtë 100% të normës së inkasimit që është arritur prej KEK-ut. Sidoqoftë, buxheti i realizuar i OPSTT-së do të mbulohet me minimum 90% të buxhetit të caktuar, edhe nëse norma e inkasimit të KEK-ut mund të bjerë poshtë 90%. Përlllogaritja do të rregullohet çdo tre muaj. Me fjalë të tjera, duhet zbatuar lidhja vijuese e bazuar në stimulim midis normës së inkasimit të KEK-ut dhe buxhetit të caktuar për OPSTT-në:

Buxheti i caktuar për 2006: €3.57m

- > 100% norma e inkasimit → buxheti pro-rata i OPSTT-së është rritur
- 95-100% norma e inkasimit → buxheti i OPSTT-së mbetet në 100% të buxhetit të caktuar
- 90-95% norma e inkasimit → buxheti pro-rata i OPSTT-së është zbritur
- < 90% norma e inkasimit → buxheti i OPSTT-së mbetet në 90% të buxhetit të caktuar

Bazuar në lidhjen e mësipërme që mbështetet në stimulim, OPSTT-ja do të ketë një buxhet minimal gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006 (faza kalimtare) prej **€1.61m** (= €3.57m * 90% * 6/12).

Kapitulli 3: Ndarjen e mekanizmit të kompensimit Ndër-OST (CBT-TNK) – të ardhurat vjetore të mundshme

Në rast se pagesat mund të merren prej OPSTT-së nga mekanizmi kompensues ndër-OST (CBT-TNK) i SETSO-as, në lidhje me rrjedhat e transitit përpara 1 korrikut 2006, atëherë në pajtim me Rregulloren e BE-së nr. 1228 /2003/EC “mbi qasjen në rrjetin për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike”, dhe në direktivat ndër-OST (CBT-TNK) të nxjerra prej KE-së më 1 shtator 2004, do të ishte e nevojshme që shqyrtohen këto pagesa për të ulur (bashkërenduar) ngarkesat tarifore të Rrjetit të Transmetimit në mënyrën e duhur. Përndryshe, pagesat mund të përdoren për të ulur tarifatat e ardhshme të rregulluara të rrjetit prej 1 janarit 2007 3 tutje.

Nga ana tjetër, “**kostot e fillimit**” të një ndërmarrjeje të ndarë priten të mbuloohen përmes ngarkesave të tarifave të rregulluara të rrjetit. Këto “kosto të fillimit” duhet t’i nënshtrohen aprovimit të rregullatorit. Për këtë arsye, pagesa që duhet të merret nga CBT-TNK përpara 1 korrikut 2006, duhet të arrijë një shumë deri në koston fillestare të OPSTT-së siç lejohet nga ZRRE-ja, e cila do t’i caktohet OPSTT-së. Nëse ekziston suficiti (mbi kostot e lejuara të fillimit), dhe më pas ndarja e caktuar midis KEK-ut dhe OPSTT-së do të jetë përkatësisht 85% dhe 15% sipas buxhetit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së KEK-ut për vitin 2006.

ZRRE-ja do të marrë një aplikacion prej OPSTT-së për të justifikuar dhe aprovuar “kostot e fillimit” prej 15 korrikut 2006 dhe do të nxjerrë një vendim ndërsa do të marrë parasysh dhe do të bashkërendisë çdo burim financash prej BKK-së dhe/ose donatorëve, për “kostot e fillimit” në shumën e lejuar.

Kapitulli 4: Aplikueshmëria

Ky vendim do të hyjë në fuqi në datën e aprovimit prej Bordit të ZRRE-së.

Aprovuar nga Bordi i ZRRE-së: Prishtinë, 28 qershor 2006

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së:

Dr. Nick Frydas

Anëtarët e Bordit:

Znj. Merita Kostari

Z. Naim Bejtullahu

Znj. Theranda Beqiri

Dr. Nysret Avdiu
